


Fillimet

Revistë nxënësish të shkollës së mesme të kombinuar "Vëllazërimi Bashkim"



nr.42 - mars 2008. Ulqin

h

GORAN

q

Jackie

James



GORAN

The Queen of Our Hearts

h

m

FOR JACKIE, WITH LOTS 'A LOVE, GORAN

FJALA E REDAKSISË

Përkundër kohës së pamjaftueshme dhe pengesave që na janë shfaqur gjatë punës, me optimizëm dhe me vullnet të plotë ju paraqesim një revistë tjetër, një tjetër „fillim”. Përmes krijimtarisë e cila nuk ka munguar në asnjë numër deri më tash dhe përmes temave aktuale që na kanë preokupuar e kemi pasqyruar në një numër të kufizuar faqesh imazhin tonë. Mund të mos jetë e përsosur, por së paku ne shpresojmë që lexuesit do të jenë të kënaqur dhe secili prej tyre do ta gjej vetveten në njërën nga faqet e revistës tonë.



Kryeredaktor,
Ali Doda, prof.

Lektor,
Islam Hoti, prof..

Realizimi kompjuterik:

Asllan Rejzi IV-5
Robert Jankoviq IV-5

Asistentë:
Admir Suloviq IV-5
Antonio Kurti IV-5
Fadil Hasiq IV-4

Redaksia:
Albana Curanoviq IV-4
Donika Çapriq IV-4
Emina Çapunoviq IV-4
Learta Hollaj IV-5
Virgjina Zadrime IV-4
Xhenana Mehmedoviq IV-5
Gresa Katana III-x
Arta Mollabeqiri II-5
Arta Cungu I-5
Rita Lulgjuraj I-5
Ulkiara Tela I-5



Basri Çapriqi për „Fillimet“ nga fillimi

Shkrimtari I shquar Basri Çapriqi I cili vite më parë botonte punimet e tija po në të njëjtën revistë, të cilën ju jeni duke e shfletuar. Duke rikujtuar të kaluarën, ku edhe ai ishte jo më shumë se një adoleshent plot ëndërra dhe plane për të ardhmen plot kënaqësi na e paraqiti atmosferën e redaksisë para tridhjetë e sa viteve ku ai ishte një ndër anëtarët e sajë.

Redaksia: Pasi që shfletuat revistën "Fillimet" të botuar vitin e kaluar, çfarë do ishin komentet e juaja mbi atë që ju përkujton një revistë e cila botohet që në kohën kur ju ishit nxënës I shkollës tonë?

B. Çapriqi: Janë emocione që të kthejnë mbrapa tridhjetë e sa vite më parë, kur revista fillimet ka qenë një organ shtypi më shumë peshë për këtë mjedis kulturorë. Në atë kohë ajo ka qenë revista e vetme që lexohej në këtë qytet dhe që me karakterin që kishte, ishte më shumë se një revistë lokale nxënësish. Ajo kishte një mision, një përpjekje për të mbushur një zbrastësirë kulturore. Ulqini i asaj periudhe nuk ishte një vend ku qarkullojnë revistat e gazetat lirëshëm dhe ku mund të shohësh kanale të shumta televizive në gjuhën shqipe. Ai ishte një vend i vogël i izoluar ku materialet e shtypura në gjuhën shqipe qarkullonin rrallë. Ato kushte ishin tejet modeste shaptofigrafohej me metoda mekanike, me një dizajn që linte shumë për të dëshiruar, me mundësi teknike tejet modeste. Fillimet e sotme janë të një kohe tjetër, e kohës se internetit, e mundësive të mëdha teknike dhe e zgjidhjeve atraktive të dizajnit.

Redaksia: Tash revista del një herë në vit cila ishte dinamika e atëhershme?

B. Çapriqi: Fillimet atëher dilnin më shpesh, disa herë gjatë vitit dhe siç e shohë tash, një ndryshim i madhë ishte se atëherë pjesa dërmuese e materialeve ishin origjinale, botoheshin për herë të parë në fillimet dhe ishin punime të nxënësve, të cilët më vonë një pjesë e tyre kanë bërë emër në përmasa më të mëdha të literaturës shqipe.

Redaksia: Si e konceptoni revistën "Fillimet" tani?

B. Çapriqi: Unë edhe sot e kësaj dite e konsideroj një punë me vlerë këtë revistë, sepse është një organ shtypi që e bëjnë nxënësit me vullnetin e tyre, me talentin e tyre, me entuziazmin e tyre. Këtu për herë të parë ata që do të merren më vonë profesionalisht me punë krijuese mësohen të punojnë me frymën e grupit ambientohen në një punë ekipore, realizojnë një projekt me forcat e tyre. Kjo do t'i përcjellë më vonë dhe do tu dal gjithmonë si një motiv që nuk shterret asnjëherë.

Redaksia: Cili ka qenë roli i profesorëve në punën me nxënësit!?

B. Çapriqi: Ka qenë një kohë e entuziazmit dhe e seriozitetit të jashtëzakonshëm në punën arsimore dhe në punën me aktivitet krijuese të nxënësve. Unë edhe sot e kësaj dite e mbaj mend për mirë punën e palodhshme, vetëmohuese të arsimtarëve të asaj kohe në gjimnazin e Ulqinit. Ia vlenë për të cekur disa na redaktorët e parë, sikurse Bajrama Rexha, Mehmet Kraja, Mehmet Bardhi etj. të cilët angazhoheshin me gjithë fuqitë intelektuale për të ndihmuar nxënësit në krijimin e një reviste që në atë kohë i tejkaloi kufijtë e revistës lokale të nxënësve. Ajo hyri në histori si organ I parë I shypit në Mal të Zi në gjuhën shqipe. Më duket që është edhe I papërsëritshëm edhe angazhimi dhe serioziteti I pedagogëve të asaj kohe në gjimnazin e Ulqinit. Unë do të potencoj grupin letrarë "SHPRESAT e GJIMNAZIT".

Redaksia: Cilat do ishin fjalët e juaja për përfundimin e kësaj interviste për anëtarët e kësaj redaksie?

B. Çapriqi: Uroj redaksinë e revistës ku edhe unë dikur kam qenë, të angazhohen shumë rreth kësaj reviste pa menduar se po humbin kohë së koti. Angazhimi në një revistë me punë kreative që nisë që nga bankat e shkollës është më shumë dobi në vitet që do vijjnë. Angazhoheni sa më shumë që revistën ta mbushni me punët tuaja krijuese dhe përfshini sa më shumë debat brenda sajë, që nesër të jeni të gatshëm të inkuadroheni në debate të mëdha në udhëkryqet e ardhëshme që u presin.

Jam, por titull s`kam


Jam libër i hapur,
por askush s`më lexon
Jam i lirë,
por askush cmimin tim s`shikon.
Faqe pak kam
por s`kuptohen dot.
Fillim s`kam,
fundi me tri pika mbaron.
Titull s`i kam vënë
por mundet "luftë"
...një luftë shpirtërore
ku zemra është top
e shpirti mur mbrojtës.

Ulkiana Tela I-5

EKZISTONTE

Ekzistonte diçka që mund të tejkalonte çdo vështirësi...
Diçka aq e fortë që mundte
edhe lotin ta përthante
edhe detin ta përçante
edhe zemrën të shëronte
Ishin fjalët që të jepnin kurajo
Ishin ditët që nuk përjetohen më
Ishin çaste që të mundësonin shpresën
Që një ditë të mos kesh frikë më...
Ekzistonte...Nuk ekziston më...

Arta Mollabeqiri II-5



Në ambientin e ri

Në jetën e njeriut pa pushim ndodhin ndryshime. Ato ndikojnë në ne, duke na ndryshuar mënyrën e gjykimit, perspektivën nga e cila shikojmë realitetin.

Edhe neve gjatë këtyre muajve na kanë ndodhur ndryshime te mëdha. Nga ajo siguri që e kemi pasur në bankat e shkollës fillore, kaluam në një ambient të panjohur, të shkollës së mesme. Akoma na duken të çuditshme klasët e reja, profesorët e rinj. Mundohemi që sa me shumë ti përshtatemi kërkesave të të tjerëve, duke u munduar që të gjejmë një balans mes mësimëve dhe shoqërisë së re. Gjithnjë e më tepër fillojmë të mendojmë për të ardhmen tonë, pasi që e kuptojmë se tani nuk jemi më fëmijë dhe lojrat tona i kemi lënë pas.

Dhe derisa ditët kalojnë, ne me kënaqësi e kuptojmë që po rritemi. Duam sa më shpejtë ti marrim frerët që vetë të vendosim se cka është e mirë për ne. Shpresoj se në gjimnaz do të fitoj diturinë e duhur për të ardhmen, si dhe shpresoj se do të krijohet një shoqëri që do të na lë kujtime të paharrueshme.

Arta Cungu I-5

Ndërsa rrugët zbrazen. Bukuri, qetësi, por nganjëherë vjen trishtimi në mendjet tona. Është trishtim, nga cka? Përgjigje të plotë nuk gjej, sepse në këtë rrugë, gjen vetëm dy botëra kundër njëra tjetrës. Njëra të fitoj... Është gjak, gjak I cili luftoi për botën e lirisë. Sa vite, mbyllur në dhomën që nuk sheh asgjë përveç murit. Fytyra të trishtuara. Shoh, botën e cila luftoi për jetë, komb, për një shpresë, të quajtur liri. Luftuan, dhe nuk u ndalën. Gjaku rrjedh, dhe ndërsa shoh tani ata që shkatrruan jetën e një të pafajshmit, I cili luftoi, për liri, jetë, familje.

Celësi I së ardhmes, pret. i quajtur LIRI.

Valona Cakuli II-9

Adoleshenca

Uf! Vet fjala duket paksa e ndërlikuar. E sikur të marrim dhe ta zbërthejmë kuptimin e saj, atëherë të kap një kokëdhimbje e tmerrshme. Jo, jo, nuk do të hy në prejardhjen e fjalës, apo diçka të tillë. Thjeshtë do të jap disa shembuj të asaj se ç'është "ADOLESHENCA".

Shembull, të jeshë adoleshent do të thotë të jetosh në një botë tënden, do të thotë të mos mërzitësh shumë e shumë për gjërat që të rrethojnë; do të thotë të dëgjosh muzikë me sa zë që të ketë gramafoni, do të thotë të nënqeshesh me 'fjalimet' që t'i mbajnë të rriturit. Shkurt, me vet fjalën adoleshent nënkuptojmë të gjitha gjërat e çuditshme që i bën një i ri nën moshën 18 vjeçare. Por, a thua vallë jemi aq të tmerrshëm? E vërtetë është se e kaluara nuk na intereson. Por, kur ta mendosh gjërë e gjatë e kaluara nuk vlen të kujtohet edhe aq shumë. E kaluara është vetëm si një pluhur që ka mbuluar kujtimet. E, kush e do pluhurin, vallë? Fundja, të kaluar të gjatë që kemi ne! Është e vërtetë se nuk mendojmë shumë e shumë as për të ardhmen - këtë e pranoj. Por edhe e ardhmja është si një mjegull e cila nuk dihet se ç'është. Atëherë pse të lodhemi me diçka të padukshme? Pastaj na thoni të papjekur! E pse qenkemi aq të papjekur se? Sepse jetojmë për të sotmen? Sepse jetojmë për të tashmen? Hmmm! E tashmja mua më duket më e logjikshme. Është diçka që e ndjej dhe e përjetoj.

Por, me siguri nuk e kam në të. Si çdo i ri me siguri kam mendime të gabuara mbi të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Por, nuk gaboj kur them se nuk keni pse frikësoheni aq shumë për ne. Edhe nëse gabojmë ndokur, njerëz jemi dhe gjërat mund të përmirësohen. Vetëm kini pak durim sa t'i kalojmë këto vitet e çuditshme, dhe gjërat do të vinë në vendin e vet.

Aldina Rexha III-7

Ku tani?!

“Superfuqia” e mbetur nga gërmadhat e ish-Jugosllavisë nuk e mendonte kurrë që do vinte momenti që “djepi I shenjtë I saj” të bëhej prap djep I pavarur. Në një moment kur populli shqiptarë po përjeton tranzicion dhe një krizë të thellë sociale, ndodhin ndryshime titanike, për të cilat ne duhet të bëjmë një sforcim të dukshëm apo një konsumim overdoze “proteinash” në mënyrë që **EVROPA** të shohë pjekurinë dhe aftësinë e vetadministrimit në një territor që thëriste për udhëheqësit autentik. E gjithë situata mund të marrë një trajtë matematikore. Aty ku ishim, shenohet me vlerat nga “minus pakufi” deri në një zero të plogësht, aty ku gjendemi shenon në zero të vektorit të historisë moderne, aty ku do jemi kërkon një ekuacion të ri me shumë alternativa zgjedhëse, por medoemos ato të variojnë në mes vlerave pozitive dhe të japin mundësi zgjedhjesh për një të ardhme “ashtu siç e duam”.

Vitet e '90-ta sikur kërkonin një frymë të re dhe një drjetim të ri në rrugët e historisë, që realisht përkonte me pikënisjen e krejt trazirave, dhe nuk është aspak koinçidues ky fakt. Mirëpo, vetëm e tillë, treva e Ballkanit do mund të mbyllte këtë plagë të hapur.

“17 Shkurti” vuri një pikë dhe i priu një kapitulli që do e shkruajmë ne, **vetë**, që nga shkronja e parë. Kjo shkakton një lloj skepticizmi mbi atë se “a u mbyll kjo plagë vërtetë?” apo do mbetet e hapur dhe do marrë trajtën e një krateri vullkanik që në mënyrë kontinuale do mbetet i aktivizuar.

Kërkuam ndryshime, të drejtën që na takonte dhe ne se kuptojmë se sa të rënda janë pasojat që po lë fenomeni “tranzicion”. Me të trashëguam një mentalitet dhe një kulturë të izoluar. Kastet politike luftonin për një definim të statusit politik dhe një fillim të ndërtimit të kapaciteteve demokratike nën trysinë e një regjimi të egër kolonial serb. Flatrat u liruan, çka vjen tani?

Sikur gjatë tërë këtyre viteve harruam se mes “njohjes formale të pavarësisë” dhe problemeve egzistenciale të qytetarëve egzistonte një mal i madhë problemesh që duheshin zgjidhur urgjentisht për qytetarët e pamësuar me detyrat dhe obligimet që dilnin nga mënyra demokratike e qeverisjes. Kjo nuk ndodhë edhe aq për shkak të zgjedhjes që u bë, sa nga shkak i nevojës së spjegimit të dilemave të mëvonshme që do të paraqitën në periudhën e paspavarësisë në formën e krizës së identitetit: moral, politik, juridike e sidomos ekonomik, dëshmitarë të cilit proces jemi edhe ne sot.

“Lufta” vazhdon...por kësaj here nuk ka dy fronte, tani kërkohej vetëm një-**mbrojtje me dinjitet**.

Proverba

Fitoret e përjetshme janë ato të paqes, e jo të luftës. (Ralph Waldo Emerson)

Kur do bëhet vetëdija e njerëzve aq sensible që në vend të hakmerren për mjerimin njerëzorë ta parandalojnë atë. (Eleanor Roosevelt)

-Për luftë nevojiten tri gjëra,para,para dhe më shumë para. (Nicholo Machiaveli)

-Është një fakt shqetësues se e vetmaj mënyrë për të siguruar paqë është lufta. (John F. Kennedy)
Secila armë që është prodhuar, çdo luftë që bëhet, çdo bombë që eksplodon, në fund të fundit nuk është asgjë tjetër përveç se një vjedhje ndaj atyre që janë të uritur dhe nuk ushqehen, atyre që ngrihen e nuk vishen. Bota duke ndërtuar armë nuk harxhon vetëm para. Harxhon djerësen e puntëtorëve të saj, gjenialitetin e shkenctarëve të saj, dhe shpresat e fëmijëve. (DWIGHT D. EISENHOWER)

-Nuk mund të thuash që civilizimi nuk përparon, derisa në cdo luftë të re gjejnë një mënyrë të re për të vvarë. (Will Rogers)

-Imagine all the people living life in peace. You may say I'm a dreamer, but I'm not the only one. I hope someday you'll join us, and the world will live as one. (John Lennon)

Pa cenzurë!

14.10.'07 ... ditë e shënuar në kalendarin vjetorë të maturantëve me një fjalë të vetme – ITALIA. Nuk e kuptuam as vetë si ,kur, çfarë, ... por disi ne u gjendëm të gjithë të mbledhur te „Londoni”. Kush do mendonte se të gjithë ato buzëqeshje në rrugën e kthimit do shëndrroheshin në lotë mallëngjimi.

Koncepti i maturantëve mbi ekskurzionin si “udhëtimi i paharrueshëm rinor” i mbushur me plane dhe pritje të mëdha në rrugë të sipërme u shëndrrua në një ankth të cilit me veshitësi i rezistua deri në fund. Me një fjalë e permblodhur “organizimi” ishte mos të themi katastrof, por afër kufinjve të dështimit.

Komentet më të dëgjua gjatë tërë rrugës tingëllonin kështu: “kur pa mrrisim ma? Ç'na u desht m'u nisë?!

E ky Slloboja...gen..birë.. qeni”...gjë që rezulton ironike, sepse në autobusët tanë duhej të tingëllonte vetëm kënga.

Për fat të keq i vetmi vend ku nuk na ndante ky organizim” shumëpremtues” ishte FERRY BOAT

.Vetëm aty arritëm të ndihemi si një ekskurzion i vetëm, por me kalimin e mileve anija sikur zbarkonte entuziazmin tonë,

sepse papritmas ne kuptuam se do ndahemi në grupe sipas dëshires së organizatorit, dhe në pamundësi që të shprehim dëshirën tonë.

Odisea jonë kishte për pikënisje Barin, të cilin e përjetuam vetëm si tranzit në rrugë për Romë.

Dita e parë perfundoi në shetitje në rrahë koncentrik me qendër Koloseumin.

ITALIA



Doom Charaveli Yaraveli

Në fillim ishte muzika. Ajo e vjetra. Popullore. Ndihëm i entuziazmuar sa herë që dëgjoj tinguj burimor të muzikës e sidomos asaj ulqinake. Mendoj se sa fabul kishin vargjet e atyre këngëve të cilat ishin *soundtrack* (fonogram) i jetës shoqërore. Vargjet si "o Tahir a po vjen o me gjue, merr zagart edhe hajd'o me mue" reflektonin përditëshmërinë dhe vlerat e mirëfillta etnokulturore.

Diçka e cuditshme po ndodh në botën moderne. Fjala është për një proces të diskutueshëm të quajtur globalizim. Me përparimin e avansuar të teknologjisë paraqitet globalizimi si proces botëror i interaksionit dhe integritit në mes njerëzve, kompanive dhe qevërive të popujve të ndryshëm në planin politik, kulturor e sidomos atë ekonomik. Krijimi i një tregu të gjërë dhe global rrjedhimisht bën të mundur plasimin e produkteve të ndryshme të kompanive të mëdha por gjithashtu edhe përhapjen e disa vlerave shoqërore-kulturore të reja. Globalizimi sjell me vete tendencën që të krijohet një kulture globale në të katër anët e botës, si në New York ashtu edhe në Dubai. Vendet e pazhvilluara ekonomikisht më tepër marrin sesa japin nga kultura e tyre. Paramendoni se jeni në Shangai, në një restaurant dhe porositni lulesheg. Aspak reale, apo jo? Epo ja që llampat me vizatime të dinastisë Ming dhe me muzikë kineze mund t'i gjeni në disa shitore në qytet.


Duke iu "faleminderuar" këtij fenomeni planetar përhapet një shikim tjetër mbi skenën e show-biznisit. Elementet e kësaj "kulture globale" kanë ndikim në kulturat dhe identitetin nacionalo-folklorik të vendëve të pazhvilluara. Këto elemente moderne priten duarhapur nga popujt të ndryshëm dhe përzihen me kulturën e tyre lokale. Kështu në TV e vetëm në qytetin tonë kemi rastin të dëgjojmë këngë folklorike si "Dum sharaveli" të shoqëruara me ritme disco/house. Pikërisht në këtë përzirje (lamsh) të kulturave përendimore dhe lindore me atë vendase e ka origjinën muzika më e ndëgjuar në Ulqin ... turbofolk.

Termin "turbofolk" i pari e ka përdorur gitaristi i shquar Rambo Amadeus ku *turbo* si koncept bashkohor paraqet elementin modern ndërsa *folk* është sinonim për karakteristikat tradicionale popullore të këtij zhanri. Në fillim të viteve '90 kjo muzikë kishte për bazë ideologjike nacionalizmin dhe më së tepërmi ndëgjohej në viset rurale. Sot gjërat kanë ndryshuar pasi që në lojë hyri kultura globale dhe turbofolku merr dimensione më moderne por ruan *mentalitetin* popullor në tekste dhe muzikë. Këngëtarët në fillim ishin të sponsoruar nga mafia dhe profiteret e luftës por ato sot kanë një pamje krejtësisht tjetër. Ato janë të veshur me rroba të shtrenjta, kanë menaxherët e tyre personal, shetisin me makina luksoze dhe interpretojnë në diskotekat europiane kudo që ka popull nga Ballkani. Janë pothuajse për çdo ditë nëpër media. I gjithë ky shkëlqim ekskluziv i tyre në publik nuk është kurgjë tjetër veçse kopje e dobtë e stilit të MTV-së amerikane.

Ritmi pop, r'n'b apo house i kombinuar me harmonikë dhe tekste me tematikë të përditshme lokale të "paketuara" si në Hollywood paraqet turbofolkun aktual.

Ky kiç dhe kjo megjull joreale është i përshtatshëm dhe i lakmueshëm për masën. Ky "hollivudizim i ri i realitetit" përqafohet nga "njeriu ballkanik" dhe pranohet si ikje nga realiteti i përditshëm. Në këngën e saj hit Bleona Qereti të dashurit i kërkon "shampanjë në pishinë, diamante 3 karatësh, koleksione Dolce&Gabbana"... Cka është muzika? Muzika është art. Të ndëgjosh muzikë dhe të identifikohesh me fabulën të këngës do të thotë ti takosh në njëfarë mënyre poetit. Cilat janë ato vlera që i promovon turbofolku? Cili është mesazhi që përcjell?
The answer my friend is blowing in the wind...

Arben Kalabrezi, IV-5



"Google-izim"

Dikur do bënin çmos sikur të gjenin një pendë, ta ngjynin në bojë dhe të hidhnin ca mendime në letër. Sa gëzim do të sillte kjo. Tani pendat ruhen në muze, së shpejti atyre do iu bashkangjiten stilolapset. Kompjuteri përfshiu në vete "boten". Roli i tij është bërë i pa zëvendësueshëm, sundues, i gjithanshëm, gjithpërfshirës-arrin të manovrojë me një glob të tërë. Po diku një gabim do gjendet edhe në këtë aftësi të shfrenuar, sepse ne e dijme shumë mirë që "çdo gjë e tepruar – është mekat". Dhe befasisht ne takojmë në kontradita, tani kemi mjetet, kemi të gjitha kushtet, por s' kemi kryesoren, neve na mungon thelbësorja –vullneti, apo mbase kjo është thjeshtë pasojë e kohës ne mungesë dhe stresit për të arrirë shumë gjëra, e që në fakt po ti hjedhim një shikim dioptrik, ska nevojë të jetë shumë largamës e as shumë cilësorë, të kuptojmë se ne jemi bërë "sipërfaqësorë". Çdo gjë ka humbur lezetin, tani ka vend veç për dinamik dhe si pasojë e saj vetëm për stres. Kemi harruar cilësitë themelore, kemi harruar të sodisim të bukuren, të natyrshmen, ne tani dijme të deshifrojmë në trurin tonë të modernizuar vetëm "elektronik". E në fakt nuk kuptojmë që ajo po na deshirform neve- po na shkatron. "Google", Youtube, Wikipedia, My Space- "të gjitha në një vend" do thonin gojë naive, këtu ne gjejmë çdo gjë. Po libri, vepra, të udhëtuarit, të mësuarit a është e mundur që këto janë vetëm ca "anticitetet" të epokës së re. Sikur e gjithë kjo mbetet enigmatike dhe mjaft e pamundur për të gjetur një barazim në mes këtyre fenomeneve. Themi që ky qenka maksimumi, por unë maksimumin e konceptoja ndryshe. Të paktën në atë maksimumin tim nuk shihja arsy për tu mohuar jeta private, për të startuar ditën me tragjeditë që versulen nga pikat dhe pikëpresjet e globit toksorë, që loja e fëmijeve të zëvendësohej me virtualitetin kompjuterik.

Ne nuk e shijojmë dot një ngjarje deri në fund, sepse ajo te serviret në versione të pafund dhe ti prap mbetesh i ngecur, dhe më "e kendshme" është të bësh blerje përmes tregut elektronik (E-bay).

Dhe në fund ne përfudnojmë me një email të dërguar shokut apo shoqes me një subjekt "e/i dashur, më mungon shumë, ka kohë pa të parë" në vend të një kafeje diku në një lokal në ambient të hapur. Dhe lista ska fund... dhe ti e kupton se të gjitha këto të janë bërë pjesë e përditshmërisë, dhe unë vetëm tani e kuptoj se sa të mjerë e të vuajtur jemi bërë. Izolim degjenerues.

Mirëpo përderisa të ekzistojë ligjësia e natyrës, natyra e bën të veten, natyra nuk ka sfidues! Elektronika mbetet prap vetëm një alternativë, një pikë uji në oqean.

Dhjetë shenja që vërtetojnë që jeni duke jetuar në shekullin XXI

1. Kur zgjohesh në mëngjes më parë konektohesh me internet dhe pastaj pinë kafën e mëngjesit.
2. Komunikon disa herë në ditë me një të panjohur nga Afrika, por nuk keni pasur kontakt me fqinjët më të afërt ende në këtë vit.
3. Ke së paku 10 numra telefoni për të kontaktuar me familjen prej 4 anëtarëve.
4. Arsyeja për të cilën keni humbur kontakt me të afërmit është se ato nuk kanë email.
5. Të jesh i organizuar do të thotë i ndash shënimet me anë të ngjyrave të fletëve.
6. E lajmëroni djaln tuaj se buka është gati me anë të një mesazhi telefonik, ndërsa ai ju pyet me email se cka ka për të ngrënë.
7. Ke një linjë të veçantë telefonike për të pranuar telefonata.
8. Zgjohesh në ora 2.00 për të shkuar në toalet dhe në rrugën e kthimit e kontrollon emailin.
9. Ndaleni në rrugën para shtëpisë tuaj dhe përdorni telefonin për të pyetur a është kush në shtëpi.
10. Blen një kompjuter dhe një javë më pas çmimi i është përgjysmuar.

„Veronika vendos të vdesë” Paulo Coelho

Që nga botimi i romanit të tij të parë (1985), Paulo Coelho ka pushtuar tregun botëror duke arritur të shesë rreth 30 milion kopje të veprave të veta. Ato janë përkthyer në 44 gjuhë, në më se 100 vende të botës. Lexuesit e tij janë kryesisht të rinjtë. Një nga veprat, e cila vazhdon të jetë best-seller në shumicën e vendeve që nga botimi i saj i parë (1998), është „Veronika vendos të vdesë”.

Trajtimi i një teme mjaft aktuale e bën romanin „Veronika vendos të vdesë” shumë të afërt për lexuesin. Veronika, një vajzë sllovene 24 vjeçare, e cila duket sikur ka arritur gjithçka në jetë vendos të vetëvritet. Ajo nuk dëshiron që jeta e saj të shëndrrohet në rutinë dhe është e bindur se pas disa vitesh kjo gjë do të ndodhë. Më 21 nëntor 1997 ajo gëlltit një dozë të madhe qetësuesish (4 kuti). Fakti që autori e vendos ngjarjen në Slloveni, pra në një kontinent tjetër (autori është brazilian), e përgjithson veprën deri në përmasa botërore. Ai përpiqet që përmes veprës së vet t’ua përcjellë të gjithë të rinjtë të botës mesazhin se jeta ia vlen të jetohej. Pas zgjimit në një spital psikiatrik (Viletë), asaj i thuhet (pa qenë e vërtetë) se i kanë mbetur rreth pesë ditë jetë, ngase qetësuesit i kishin shkaktuar dëme në organizëm. Pikërisht gjatë atyre ditëve, Veronikës i zgjohet dëshira për jetë. Njeh urrejtjen, dashurinë, dhëmbjen, kënaqësinë dhe pjesën e çmendur të vetvetes, duke mësuar të ndihet plotësisht e gjallë. Pas pesë ditësh, ajo arratiset nga spitali e gjallë dhe e gatshme të jetojë aq sa Zoti (apo natyra) t’i ketë caktuar. Vepra është e bazuar në ngjarje të vërtetë. Autori e njeh ambientin dhe e përshkruan deri në detaje, gjë që e bën veprën akoma më reale. Vetë autori ka qenë i mbyllur në një spital psikiatrik, nga ku është arratisur (si Eduardi). Ai thotë se edhe aty ka njerëz tepër normalë, të strehuar pas mureve të çmendinës për t’u fshehur nga frika e së panjohurës. Personazhe të tilla janë: Zedka (vuan nga depresioni), Maria (ka kriza paniku) dhe Eduardi (skizofren) me të cilin Veronika dashurohet dhe arrin ta kthejë në botën reale. Një personazh mjaft interesant është dr. Igor, i cili përpiqet të vejë në jetë metodat e reja dhe të bëjë revolucion në fushën e psikologjisë. Teoria e tij mbi Virtiolin-helmin mendor është mjaft e besueshme. Vepra është mjaft e thjeshtë për nga struktura. Monologët janë fare të rrallë dhe të shkurtër. Dialogët poashtu të shkurtër edhe pse pak më të shpeshtë. Pejsazhet gati mungojnë. Autori përqëndrohet kryesisht në botën shpirtërore dhe psikike të personazheve. Episodet e shpeshta e pasurojnë veprën me informacione nga më të ndryshmet (kryesisht nga fusha e psikologjisë). Autori përdor stil të veçantë, që e bën mjaft të afërt me lexuesin veprën e tij. Në këtë vepër ai është mjaft i pëmbajtur kur bëhet fjalë për gjuhën e veprës. Një stil i mesëm, pak a shumë i rënduar nuk do të përshtatej me temën që trajtohet. Nga tropet dhe figurat stilistike përdorë kryesisht hipotipozën dhe sinekdokën, fare rrallë krahasimin duke iu shmangur mjeshhtërisht atyre të zakonshmeve siç janë: metafora, antiteza, epiteti, etj., që janë mjaft të shpeshta për krijimtarinë e tij në përgjithsi.

P. Coelho prek gjithmonë tema të rëndësishme të jetës së përditshme. Kjo bën që veprat e tij të kenë ndikim të madh tek lexuesi dhe botëkuptimet e tij. Autori jep zgjidhjen e problemit për të cilin flet, duke u përpjekur që ta bëjë optimist lexuesin dhe ta bindë atë se problemi në fjalë ka zgjidhje. Shumë të rinj shprehen se vetëm mendimi që vdekja është afër, i bën të dalin nga depresioni (disa madje të kalojnë në eufori) dhe ta duan jetën.

J. S.

Për shkak të ndryshimeve të shumta fiziologjike e sidomos psikike, adoleshenca është shëndrruar në moshën më delikate e që në trajtimin e saj duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Ky kujdes esencial i bie barrë prindërve në rend të parë dhe institucionit edukativo-arsimorë shkollë gjegjësisht mësimit në moshën më të vogël.

Mungesa e principeve elementare: të fitosh dije të vërtetë, të bëhesh i aftë, të kesh moral e përgjegjësi, janë shkak kryesorë i injorancës që na ka përfshirë. Ky shkak është shfrytëzuar si shkas për të arsyetuar paaftësinë dhe përtacinë e mësimit dhe nxënësve, për arsyetimin e situatës, pajtimin me të dhe mbajtjes së ndërgjegjes së "pastër". Frika që na mbërthen kur gjendemi në biseda serioze, intelektuale dhe me vlerë është pasojë e një arsimit të dobët dhe një shkolle që të gjithë nxënësit tashmë e konsiderojnë argëtim. Disiplina dhe kushtet që i mungojnë institucionit dhe objektit shkollë; përtacia, jo serioziteti e në disa raste edhe paaftësia e mësimit; nxënës pa ideale dhe interesa, pa seriozitet dhe të pa vetëdijshëm për vlerat, po rrënojnë integritetin e këtij qyteti të vogël por dëshpërimisht në nevojë. Gjenerata të tëra të degjeneruara në këtë aspekt vlerësohen maksimalisht nga prizma e të verbërve, që kjo situatë ju duket në nivelin më të lartë, sepse vetë i takojnë elitës së rremë. Asgjë nuk ndodhë vetëvetiu! Shkaku ekziston!

Modernizimi i tepruar, humbja e vlerave na ka mjeruar intelektualisht. Koha kur aspirata më e madhe e një adoleshenti është një motocikletë e shpejtë apo telefon mobil i kohës së fundit gjendet në ajrin e çdo shtëpie të Ulqinit. Libri...ka zënë pluhur...apo nuk ekziston fare në shtëpi! Ekzekutues të kësaj masakre intelektuale janë edhe mësimit! Mungesa e theksuar pedagogjike por raste-raste edhe profesionale, faktorë esencial që ndikojnë në mos arsimimin tonë. Pas këtyre pason mos interesimi dhe padituria e nxënësve. Disa do të mendonin se dora e hekurt do ishte zgjidhja e vetme! Unë them jo! Një mënyrë specifike dhe adekuate e sjelljes së mësimit, ku do të kombinohehin mirësjellja, mirëkuptimi, profesionalizmi, serioziteti dhe angazhimi me shpirtë, që do pasonte në pretendim më të madh dhe strikt ndaj nxënësve; do shëndrronte nxënësit në individ më të ndjeshëm ndaj vlerave morale e intelektuale, rrespektit dhe dashurisë, ndrojtjes dhe përgjegjshmërisë.

Koha që mësimit e shohim si detyrim ndaj të tjerëve, kompenzim material të suksesit të lartë dhe numër (notë), duhet të marrë fund. Diturinë nuk ua kemi borxh as mësimit as prindërve, por vehtes.

Kështu duhet të marrin fund edhe mësimit që atë na e japin në formë të detyrimit, superior, mbi ne! Lënda nuk është pronë e tyre, por detyrim ndaj nesh!

Arbëra Avdiu IV-5

Ëndërr plastike

Esenca e të qenit njeri është se kurrë nuk ka për të arritur në perfeksion. Ndoshta kjo fjali e rrëmbëu buzëqeshjen nga fytyrat tuaja, por mos u zhgënjëni. Ti je aq më perfekt deri sa je vetvetja dhe kurrë mos u mendo të lakmosh dikë tjetër.

Është kjo një e metë e qenieve njerëzore, të cilët çdo herë janë në kërkim për "perfeksion" dhe shpesh herë dëshpërohen. Të gjithë ne dëshirojmë të kemi një pamje perfekte dhe t'i ngjajmë yjeve të estradës. Bota me zhvillimin e teknikës është duke ofruar dita ditës më shumë mundësi që njerëzit të përmirësojnë të "metat e tyre fizike". Të gjithë i nisen kësaj rruge me mendim se ajo do ndryshojë çdo gjë dhe do i bëjë të lumtur. Por asgjë nuk është e përjetshme. Kjo lumturi plastike do shuhet me kohë dhe prap do shihni para pasqyrës të njëjtin njeri të markuar me marker të zi duke ëndërruar për pamjen e një aktoreje të Holivudit. Sot operacionet plastike po bëhen një mënyrë trendi dhe numri i pacienteve shtohet çdo ditë. Por pasojat janë shpesh herë drastike. E tërë ajo ëndërr kthehet në një traumë, e cila lë pas të meta fizike e jo më pak psikike. Operacionet plastike mund të kenë pasojat të mëdha, por siç duket njerëzit po e ndjekin këtë "ëndërr" symbyllur dhe po bëhen viktimat të naivitetit të tyre. Pyeteni veten a ia vlenë? A është pamja ajo që ju definojnë si person. Çdo ditë e më shumë njerëz po dalin të zhgënjyer, por tani gjenden në një rrugë të pakthim dhe në jetën tuaj s'do dominojë dëshira për të qenë "perfekt", por për të qenë i shëndetshëm e ndoshta edhe për të mbijetuar. Në fund kjo mbetet një vendim që secili njeri mund ta marrë për vete, sepse pasojat do jenë "bonus" të cilin sdo mund ta ndani me tjerët edhe sikur të donit.

Të kthehemi pikërisht tek ti që je duke lexuar këtë artikull. Mos humb kohë para pasqyrës t'i ngjash dikuj tjetër, se të jesh kopje e dikuj është e lehtë. Mundohu çdo herë të jesh vetvetja që në fund të mund të thuash "kam qenë i veçantë". B.U!

Përderisa Vatikani na i hapte dyert "ne e refuzonim" vazhdimisht, megjithëse dy vozitës rezultuan më inteligjent dhe arritën të deshifrojnë sinjalet elektronike që udhëzonim për tu gjetur në rrugët e Romës. Pas 28 orëve ne u vendosëm përfundimisht në hotel, të shpërndarë në provincat periferike të Romës.

Dita e dytë filloi me rrezet e diellit. Fontana di Trevi, Colosseo, Pantenoni, Foro Romano, Piazza di Spagna etj, ishin po aq shumë mahnitëse sa edhe i pritshim. Rrugët e Romës na bënë të kthehemi mbrapa në kohën e të madhit Cezar. Përderisa Cezari thoshte "Veni, Vidi, Vici", ne themi "Veni, Vidi, ... shpejt u largova" sepse për mrekullitë e Romës 24 orë e mos më pak janë tepër të pakta. Aventura jonë vijoi në agoni në autobus për në Firence, sepse rruga duket sikur çdo pesë minuta zgjatej për një orë. Të paktën Firence i kishte mbledhur të gjitha ëmbëlsirat në vete. Këtë qytet e mbanin të pavdekshëm "ura e vjetër" apo Ponte Vecchio, pastaj katedralja ku mishërohej e gjithë historia e artit - Santa Maria di Crocce. Statuja e përsosur e Davidit dhe ngrohtësia mikpritëse italiane. Përalla përfundoi në disko, ku organizatori nuk u mundua shumë të na siguronte një ambient të sigurtë e as të përshtatshëm, por të cilin ne me entuziasmin tonë e sollëm në nivelet e normales. Momenti romantik i ekskurzionit erdhi te ballkoni i dashnores së Veronës - Zhulietës, për të vazhduar pastaj në gondolat e Venedikut. Kanalet e ngushta ishin plotë premtime dhe çdo kënd premtonte një përjetim përrallorë, një kënaqesi në vete.

Një ekskurzion ky gjashtë ditore, por për të përshkruar përjetimet tona qoftë negative dhe ato pozitive, s'do arrinim të gjenim fjalët e duhura. Me plotë gojë mund të themi që nuk do ngurronim që sërish t'i kthehemi asaj aventure që përherë do qëndroj në kujtesën tonë.

Italia mama mia!



Çka fshihet përtej xhamave të zi?

Ndoshta jemi tepër të sinqertë, por me rënie të zilit ne shpesh zëvendësojmë bankat e shkollës me separatë e "Paradiso"-s. Muzika çdo herë e përzgjedhur mirë dhe me dinamikë mbulon bisedat e hareshme të nxënësve të shkollës tonë apo thjeshtë të njerëzve të cilët vijnë për të pirë kafe, e cila tanimë përmendet si e pazëvendësueshme dhe se nuk krahasohet me asnjë lokal tjetër të Ulqinit. I çuditshëm është fakti se profesorët dhe prindërit tanë shpesh herë e kanë vënë në debat temën mbi këto lokale, e në shumicën e rasteve duke propozuar mbylljen e tyre derisa të mos zgjidhet kjo çështje.

Në këto ditë po "arsimohemi" me këtë ambient duke e bërë vizitën aty pjesë të ritmit së përditshmërisë. T'i shikosh nga jashtë të themi të drejtën, pamja nuk të lë indiferent, por të gjithë ju që zhgënjeheni me kaq bëni një gabim të madh. Pas këtyre xhamave nuk fshihet asgjë: një atmosferë e thjeshtë rinore, të gjithë të mbledhur në grupe, ku ato mundohen të thejnë sadopak "monotoninë" e përditshmërisë shkollore. A mos janë këto lokale fajtorë për këtë zgjedhje të nxënësve? Është kjo një pyetje e thjeshtë e cila mbetet për tu pergjegjur. Mirëpo ne jemi dëshmitarët e gjithë asaj se çka fshihet pas atyre xhamave, jeni edhe JU.

Tani ne po vazhdojmë të pijmë kafet tona sa nuk na janë ftohur, ndërsa ju nxënës duhet të keni kufinj dhe duhet të dini se orët, edhe pse ne i konsiderojmë të "mërzitshme" një ditë do t'ju shërbejnë në jetë.

E zeza është fakt se simbolizon të keqen, por të mos harrojmë as edhe në një çast të vetëm një pjesë të një thënie të lashtë, të cilës ne do i japim këtë trajtë pitureske "edhe në çdo të zezë ka çdo herë një pike të bardhë".



Grindja e vajzave-gjithnjë e më TRENDY!!!!

Paqartësitë dhe mosmarrëveshjet mes nxënësve të kësaj shkolle, ç' do ditë e më shumë po zgjidhen me "grindje publike". Është dhuna ajo e cila kohëve të fundit zëvendëson dialogun në mes nxënësve. Vallë, a është kjo mënyra më adekuate për zgjedhjen e problemeve apo rruga më e shkurtër drejt publicitetit?! Publiciteti i cili ka filluar të modernizohet me shfaqjen e tyre në internet dhe reklamimin e "urtësive". Dëfrimi nëpërmjet YOU TUBE mbetet një atraksion i shkollës sonë. Neve sna ka mbetur gjë tjetër veç të luajmë rolin e spektatorit mbi veprimet e degjeneruara.

Sot

Sot...edhe sot..
u ngriva nga të ftoftet e këtij dielli përcëllues
nuk i ndej më gishtat e dorës...
nuk mund të luaj në instrumentin e këngës së vuajtjes...
shpresa është ngrirë aty ku ishte...
nuk mundet madje as të vdes...
e pret pronarin e zemrës së saj...

Pres... nuk u lodha
edhe sot dua të jem ajo qe dua...
nuk ia arrij...më shkoi munda kot...
në brendësinë time gjithcka është e paqartë...
nuk arrij të njihëm...nuk e gjej veten në atë paqartësi...
dëgjoj vetëm emrin tënd...
dhe ti nuk ndihesh njëjtë...

Ne ndjenjën e Dashurisë time vërshuan të rëshura...
Krenaria ka ngritur koken lart dhe nuk dorëzohet para lotëve...
Falenderohem që janë vetem pika vese...
po të ishte breshër do të më lëndonte edhe shpirtin...
Nuk e meritova te ishte as kjo ...
të paktën jo Sot...
të deshta me shumë se Diellin...
duket sikur ka lidhur marrëveshje me TY...
më ngrivët së bashku në të njëjën kohë, në të njëjtën ditë, në të njëjtën orë...
nuk arrita të mposht akullnajat që më mbuluan sot...
edhe batanijet me përbërje gjaku nuk po me ngrohin tani...
lotët më kapluan fytyrën pa urdhërin tim...
edhe Sot krenaria u dorëzua para tyre....

Besoj në Vetën time...do jetë vetëm një Sfidë që do më forcojë Ndjenjat...
Nuk do të lëndohem nga të tillet...as ata nuk do të lëndohen nga unë...
Është koha ajo që do i kthejë të Gjitha

Aldina Rexha III-5



``Rinia e sotme në mes të traditës dhe realitetit jetësorë``

Historia e zhvillimit shoqëror dhe kulturor në vendin tonë në krahasim me vendet perëndimore, dallon shumë. Zë shembull kur gjyshi i një djaloshi nga përendimi ishte ambasador, gjyshi im ishte pothuajse analfabet.

Ndërsa sot unë dhe ai djalosh kemi mbërritur të jetojmë në të njëjtat kushte si dhe të shkëmbejmë njohuri njëri me tjetrin. Ky hap gjigand i evulimit drejt civilizimit medoemos që ka shkapërcyer disa shkallë të zhvillimit normal. Dhe pasojat janë më se objektive në rininë e sotme. Ne jemi brezi në transformim, mbi të cilin thyhen tradita dhe realiteti jetësor. Këto të dy bijnë në kundërshtim, dhe është tejet e vështirë të ndërthuren njëra me tjetren. Duket dhe zakonet e paraardhësve tanë duhet kujtuar si pjesë e historisë apo duhet ruajtur-respektuar-zbatuar?! Tradita është nënbashkësi e bashkësisë, botë e civilizuar! Dhe di atë që shoh se dita ditës kjo po shkrihet me modernen e lakmueshme. Është vështirë të përcaktohem ngase në anën tjetër qëndron ajo që dëshirojmë. Por prapseprap prindërit mundohen me të gjitha mjetet të na udhëheqin në rrugën e cila iu duket më e mira. Të na mësojnë të jetojmë ashtu siç ata dijnë...sipas traditës. Mirëpo ndikimi i realitetit është present dhe efektiv. Është i pabesueshëm dhe i pranueshëm pasi që mundëson plotësimin e të gjitha epsheve tona rinore. A mos vallë është më lehtë të heqim dorë nga njëra dhe të jetojmë me tjetrën...

Rudina Lulgjuraj IV-5

Shiu

...dhe ai bie, pa u ndalur, pa kuptim, pa arsye,
 Bie, dhe lag cdo gjë.
 Më lag mua, prun një lodhje në cdo kënd
 A qanë kush atje nalt?
 ...ska përgjigje, e vayhdon të bie
 Të lag, të vjetroj gjërat, ti plak gjërat,
 Pik për pik në sytë e gjithkujt,
 Bie në një botë qorrash
 Që nuk e shikojn fare.
 ...e vazhdon të bie
 Ska rëndësi a e shofin,
 Troket në kokën e cdo gjëje.
 A janë lot?
 ...ska përgjigje, e bie pa u ndalur
 Tjert punojn, ecin, vrapojn
 Edhe pse ai ende po bie.
 Cështë kjo kohë?
 Cka ka qielli?
 ...ska përgjigje sepse vetëm bie !!

Albana Curanoviq IV-4

Pa shpresë

S'je as Luli i Migjenit
 as vëllai i tij,
 je një fëmi i thjeshtë,
 këmbë e duar mpirë.

I leckosur, i palarë
 endesh rrugësh
 i paparë.

Në një cep
 kërkon mëshirë,
 në faqen e njomë
 loti i ngrirë.

Jetën jeton,
 Për ëndrra s'mendon
 udhën vazhdon
 askush s'te ndalon.



Ulkiana Tela I-5

Në zemrën time je gjallë

Një dallgë e madhe zemrën ma coptoi
 Është vdekja e vëllau që smund ta pranoj
 U rritëm si dy lule me shumë dashuri
 Por Zoti të mori, më la dhembshuri.
 Zemra e motrës digjet në brendi
 Kërkon ta takoj vëllaun përsëri
 Ta shoh dhe një herë buzqeshjen e tij
 Por është e pamundur, ai është në qetsi...
 Dua të thëras emrin e tij
 Që agimin e diellit simbolizojë
 Por smund të thëras dielli perëndoi
 E bashkë me diellin, Agimi shkoj...
 Çdokund u dallove si më i miri
 Por pa pritmas dikush te thiri.
 Ishte ai që të krijoi për vete,
 Zoti i madh të hoqi prej kësaj jete!
 Nga njëzet e një vite që jetove
 Vetëm gjashtëmbëdhjet me moter i gëzove.
 Këto vite kurr nuk do t'harrohen,
 Lojrat e tua shpesh herë më kujtohen.
 Të shoh në fotografi dhe mendoj në vete
 Smund të besoj që u ndave prej kësaj jete
 Dicka në vete më thotë
AI ËSHTË GJALLË, POR SE SHOH DOT
 Pse moj jetë e rrejshme, pse je kaq mizore
 U tregove e pamëshirshme
 E të vetmin vëlla ma more ?
 Po ç'ti bësh kësaj jete që është kaq e poshtër,
 Në vitet më të bukura ndau vëllaun me motër
 Dhe asgjë nuk është e kthyeshme
 Dhe u ndamë në dy botë të ndryshme
 Unë në këtë botë që zdi cfarë më pret
 Kurse ti vëlla lule në Xhenet
 Edhe pse tash je i vdekur,
 Në zemrën time gjallë ke mbetur.
 Do të kujtoj me mallë dhe shumë dashuri,
 Të kesh vëlla si ty është një krenari
 Kujtimet për ty përherë do ti shfletoj,
 Derisa tjem gjallë kurr nuk do t'harroj.
 Për të gjitha të falenderohem
 Shpresoj në botën tjtër me ty të takohem...

Mimoza Berjashi II-6
 (Me shumë mallë "Ëngjëllit tim")

GJUHA IME SA E ËMBËL, SA ...

Ulqinaku : Ku je bate?

Tiranasi: Hë mi lal'?

Ulqinaku: Ç'a ka t're? A je ala me te?

Tiranasi: Po, akoma jam me **amoren** time.



Ulqinaku: Ere òne ala **dopisivatem** me at t'jemen.

Tiranasi: Unë sapo erdha nga një **kroçero**, tani erdha të bëj një vizitë.

Ulqinaku: Bash m'ke **iznenadit**. Se kam **oçekivat** qi ke me ardh.

Tiranasi: Ore dak, a ka ndonjë **spacio** ku mund të dalim dhe të bëjmë qef?

Ulqinaku: Tesh **dogovoritena** ça me ba e t'kallxej.



-Fadil, pse rrin në terr?

-Ala se kam hek.

A jeni ju dyshmitarë? (dëshmitarë)

-Teut, a s'ke mujt ata punë m'I kry para se me ardhë unë? Unë jam Edmir Lika dhe përfaqësoj grupi "Tata- mata".

-Pa njtresh m'kapi, çka me ba unë. (Lemza)

Prof.Dauti: Çou.....ulu...çou!.....

Valoni: Pa baj fiskullturë.

A jeni ju kryetarë? (Për kujdestarët e ditës)

"Popusajte, milina je" (Pokusajte, milina je)

Beni : Zakaqka za gjaketa (varësja për jakne)

Prof. Dauti: Hajde ti përfaqësues i këtij grupi!

Unë jam Edmir Lika dhe përfaqësoj grupi "Tata- mata".

Dialog mosmarrëveshjes gjuhësore :

-Arjane, sto mi nerviras drugaricu?

-Nemamo stolicu.

Anita: Metalet alkaide tokësore. (Alkalino-tokësore)

Prof.Hyrija: MAÇU PIÇKU (MAÇU PIKÇU)

Intervistë me pedagogen e shkollës

Duke qenë se për një kohë na ka munguar pedagogu në shkollën tonë, para pak kohe patëm rastin që sërish të kemi një pedagog, më saktësisht pedagogen Fatmire Moliqi së cilës i bëmë disa pyetje në lidhje me punën e saj.

Redaksia: Si e ndjeni veten si pedagoge e qendrës tonë shkollore?

Pedagogu: Në rend të parë të ju them se më vjen shumë mirë që ju ka rënë në mend të më intervistoni. Unë nuk jam pedagogja e parë e kësaj shkolle. Me kënaqësi të madhe e kam pranuar këtë detyrë pasi që është një nder për mua të merrem me problemet e nxënësve dhe të komunikoj me to.

Redaksia: Na spjegoni në pika të shkurtra punën e pedagogut?

Pedagogu: Puna e pedagogut është një këshillim, njëfar komunikimi si me nxënës ashtu edhe me profesorë nga ana pedagogjike, por edhe rreth problemeve të natyrës tjetër. Puna ime është edukativo-arsimore.

Redaksia: Keni qenë disa herë pjesëmarrëse gjatë zhvillimit të orëve mësimore. Si ju duket juve atmosfera gjatë orëve dhe na flisni pak për nivelin e orëve në përgjithësi?

Pedagogu: Sa i përket mësimdhënësve nuk kam vërejtje, secili prej tyre e realizon plan-programin e vet. Kur bëhet fjalë për nxënësit mendoj se duhet të jenë më të përgatitur e më aktivë gjatë orëve. Poashtu mund të them se do duhej të përmisohej atmosfera përrreth shkollës, të mbizotërojë më tepër qetësia.

Redaksia: Cilat janë komentet tuaja për revistën tonë dhe cili do ishte mesazhi juaj për nxënësit?

Pedagogu: Kam patur rastin të shfletoj një nga numrat e mëparshëm të revistës dhe mund të them që më pëlqejnë mendimet e nxënësve, kritikën si ato pozitive por edhe ato negative. Poashtu dua të shtoj që përmes kritikave arrihet që të mos përsëriten të njëjtat gabime. Mesazhi im për të gjithë nxënësit është që të komunikojnë sa më tepër me pedagogen e shkollës, t'i tejkalojnë barrierat dhe të më drejtohen për të gjitha preokupimet e tyre si ato financiare, poashtu edhe ato me karakter të thjeshtë shkollore.

Redaksia: Ju falenderojmë për intervistën.

Pedagogu: Ju falenderoj edhe unë juve për kohën që më kushtuat.

Nxënësit më të mirë të shkollës për vitin shkollore 2007/2008

Nga:

- Viti i I-rë: Haxhere Gjenasheviq I-4
- Viti i II-të: Angjela Makoviq II-1
- Viti i III-të: Merita Haxhibeti III-5
- Viti i IV-të: Rina Muçaj IV-5

Nxënësi më i mirë i shkollës, Emina Çapunoviq IV-4

Lexuesi më aktiv i bibliotekës shkollore, Lola Zhivokoviq III-1

Në seksionin e pikturës shpërblehet nxënësi, Goran Vukçeviq III-1

Profesorët jubilearë:

Lilana Rabrenoviq-30 vjet punë.

Ramiza Gërboviq-20 vjet punë.

Riza Çobaj- 20 vjet punë.

Nezir Gjergjbitriq-20vjet punë.

Radmilla Shtesheviq-20 vjet punë.

BONUS (për shaka)

Nxënësi më problematik i shkollës, Fadil Hasiq dhe njëkohsisht më inteligjenti.

Zodiaku

Çdo shenjë e zodiakut i korrespondon një planeti, me një ngjyrë, me një gur, një parfum dhe me një pjesë astronomike të qenies humane. Shumë njerëz arrijnë ta indentifikojnë vehtën me karakteristikat e këtyre dymbëdhjetë shenjave, e ndoshta edhe ju do gjeni një surprizë të këndshme apo thjesht do jetë një zhgënjim. Derisa për shumë njerëz horoskopi shërben vec si një mënyrë e argëtimit, shumë të tjerë i japin një rëndësi të madhe duke u bazuar në të dhënat që janë përkushtuar personalitetit të secilës shenjë.

DASHI-Jeni person dinamik dhe çdoherë doni të dominoni mbi të tjerët. Urreni të kaloni kohën kot dhe doni çdoherë t'ju kenit gjërat nën kontroll. Jeni një udhëheqës i mrekullueshëm. Një e metë e juaj është se shpesh herë flitni pa menduar, duke mos u bazuar në fakte konkrete dhe kjo gjë mund të ndikojë negativisht në relacionet tuaja me njerëzit tjerë.

DEMI-Një ndër cilësitë më pozitive tuaja është durimi. Ky durim ju jep përparsi në të gjitha sferat e jetës. Gjëja që urreni më së shumti është gënjeshtria. Jeni shumë xheloz. Një veti tjetër negative është se demoralizoheni shpejt dhe kjo për ju mund të ketë pasoja të mëdha.

BINJAKËT-Dinakëria dhe mënyra me të cilën silleni me njerëzit tjerë e bën që çdo njeri të ju marrë për zemër që në momentin e takimit. Nuk lejoni që fjalët e të tjerëve të ju kalojnë pa i vërejtur. Mosdurimi juaj ndaj të tjerëve është mangësi e juaja. Vendimet I merrni shumë shpejtë duke mos pasur fakte të shqyrtuara mirë.

GAFORRJA-Ndoshta nga jashtë dukeni të ashpër dhe agresivë, por në të vërtetë jeni një ndër njerëzit më sensibil. Jeni të gatshëm çdoherë të ndihmoni të tjerët. Miqësia juaj është një gjë që ju rrit vlerën si person. Gjëja që mund të ndikojë negativisht në ju, është se e keni të vështirë të përballeni me ngjarjet nga e kaluara duke pasur frigë se do përsëriten në të ardhmen.

LUANI-Keni vetëbesim absolut. Mendoni se jeni të aftë të arrini çdo gjë dhe ambicionet tuaja nuk marrin fund. Jeni të gatshëm t'ua falni gabimet të tjerëve dhe askush nuk mund të jetë mik më i mirë se ju. Krenaria e tepërt është një cilësi negative e cila shpesh herë mund të ju ulë vetëbesimin, gjë që për ju mund të ketë pasoja drastike.

VIRGJËRESHA-Në sytë e botës jeni person i qetë edhe shpesh herë mbrenda juve ndikon nervoza dhe shqetësime të shumta. Vendimet i merrni çdoherë në bazë të fakteve racionale. Kjo gjë edhe pse veti pozitive mund të ndikojë negativisht, sepse mund të leni pas dore kreativitetin tuaj dhe ndoshta s'do realizoni idetë tuaja.

PESHORJA-Jeni shumë të këndshëm. Çdoherë dalloheni nga të tjerët. Dashuria e juaj për artin dhe të bukurën luan një rol të rëndësishëm në jetën tuaj. Jeni njerëz të drejtë dhe çdoherë keni parasysh të dy anët e ngjarjes. Një e metë e juaj, është se mundoheni ta jetoni jetën duke ëndërruar, dhe ndoshta mosplotësimi i këtyre ëndrrave do ndikojë negativisht në disponimin tuaj.


AKREPI- Mund të përshkruheni si shumë të fuqishëm dhe si të dobët, si emocional dhe si të ftohtë. Karakteristikë e juaj është besnikëria. Jeni shumë ambiciozë dhe do benit çdo gjë për të realizuar qëllimet tuaja. Të tjerët duhen të kenë kujdes nëse vendosin të bijnë në konflikt me ju, mbasi mund të jeni armik i rrezikshëm.

SHIGJETARI-Zakonisht jeni të buzëqeshur. Çdoherë të gatshëm të ndihmoni të tjerët. Sinqeriteti dhe humori ju bëjnë ju të këndshëm për shoqërinë tuaj. Nganjëherë ky sinqeritet mund të ndikojë negativisht mbase shumë njerëz kanë problem t'ju pranojnë kritikën tuaj, dhe pse ju i bëni me qëllim të mirë. Një veti negative është se nuk dini ti dilni mbanë situatave të papëlqyeshme me të cilat bëni në kontakt gjatë jetës.

BRICIAPI-Ju jeni shumë ambicioz, jeni këmbëngulës nëse bëhet fjalë për ambicionet tuaja, do bëni ç'mos që t'ju realizoni. Dukeni si një person i ftohtë dhe kjo gjë mund të ndikojë negativisht në formimin e shoqërisë.


UJORI-Keni personalitet unik në çdo aspekt. Ju i injoroni të tjerët duke menduar se idetë tuaja janë më të mira se të tjerëve. Angazhimi fizik për ju, është gati i pamundur. E urreni punën fizike, mirëpo në anën tjetër jeni shumë praktik në angazhimet tjera.

PESHQIT-Personaliteti juaj është i fuqishëm dhe kuptoni shumë shpejt kundervështrimet e të tjerëve. Keni vullnet të punoni, që të arrini qëllimet tuaja, çdoherë të gatshëm të ndihmoni të tjerët. Nuk jeni vetiak prandaj njerëzit dëshirojnë të jenë në shoqërinë tuaj. Nuk gjykoni njerëzit prej asaj se çfarë bëjnë, por prej brendësisë së tyre.



Počeci

List srednje mješovite škole "Bratstvo-Jedinstvo"



Horo(r)skop



OVAN: Bahati gadovi, uvijek moraju da budu šefovi i glavni u svemu. Zbog položaja Marsa u odnosu na Saturn, obojima se ove nedjelje ne preporučuje bježanje sa časova fizike. Zdravlje: Obratite pažnju na učestale astmatične napade.



BIK: Samozadovoljni, čutljivi daveži, dosadni kao klub filatelista. S obzirom da se vaša vladajuća planeta Venera nalazi pod sjenkom Sunca, bićete podležni „rešetanju“ profesora u ovom periodu. Al' vam zato ruže cvetaju u jrbai



BLIZANCI: Glavni ogovarači i tračare, izdajice i prevrtljivci sa dvostrukim mjerilima koja se mijenjaju svakih 15 minuta. Da li je moguće da sazvežđe Orion ima toliko pozitivan uticaj na Vas? Izgleda da ima, jer se blizancima smiješe dobre ocijene bez mnogo truda. Vraćate se staroj ljubavi...




RAK: Posesivni ludaci, uvrijede se ako im dobro jutro niste zaželeli pravilnom intonacijom i mjenjaju raspoloženje kako im padne na pamet. Zbog mjesečevih mijena trenutno ste u oblacima, škola vas ne zanima, zato pogotovo izbjegavajte časove društvenih nauka utorkom i četvrtkom. Neko će vas pošteno ispaliti u martu.




LAV: Arogantni, vječni potcenjivači, puni velikih planova za sve koji na kraju koriste samo njima, kao da ih je i briga za druge. Imajući u vidu da je Sunce na Vašoj strani, sijate na časovima, postići ćete dobre rezultate u prirodnim naukama. Skrivajte ljubav. Ne trudite se, na kilometar se primjećuje.



DJEVICA: Opsesivno kompulsivni neurotici koji se stresa oslobadaju čisteći stan, slažući garderobu i porcelan. Prezahitve cjeplidlake kojima ni previše nije dovoljno. Bilo je i krajnje vrijeme da Djevice procvjetaju uporedo sa lalama. U vašem životu se rađa nova ljubav, ali to nije razlog da zanemarite školu koja inače trpi samo vaše fizičko prisustvo na času.




